FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 171

Tiranë – E mërkurë, 3 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13298, datë 27.10.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	15353
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 412, datë 28.10.2021	Për miratimin e rregullores "Për matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë të naftës"	15353
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 697, datë 22.10.2021	Për delegim kompetencash	15357
Urdhër i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 925, datë 29.10.2021	Për miratimin e formularit të deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë	15358
Urdhër i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 926, datë 29.10.2021	Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave privatë	15373
Udhëzim i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 927, datë 1.11.2021	Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike, në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit (EACIDS)	15443
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 15576, datë 1.11.2021	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare	15446
	Argumentet e votës "kundër" për aktin "Për miratimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021", e anëtarëve të Komisionit Rregullator	15446

DEKRET
Nr. 13298, datë 27.10.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 e 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Ferdinand Martin Luci
2. Nosh Pjetër Xhanaj
3. Xhulia Bujar Rami
4. Mimoza Bajram Gelaj
5. Renold Petraq Vasili
6. Kostadin Renold Vasili
7. Adriana Renold Vasili
8. Bledar Besim Elezi
9. Besmira Genc Elmazi (Dedja)
10. Jonel Besmir Elmazi
11. Arjen Besmir Elmazi
12. Gojko Vido Kontiq
13. Marlin Maksim Haxhiu
14. Klea Shkëlqim Kola
15. Iris Fatos Bardhi
16. Gersa Ilirjan Hysena

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR
Nr. 412, datë 28.10.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES[1] "PËR MATJEN E TONAZHIT TË DEPOZITAVE TË BALASTIT TË VEÇUAR NË ANIJET CISTERNË TË NAFTËS"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 54, pika 4, dhe nenit 401, germa "b", të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë të naftës", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR MATJEN E TONAZHIT TË DEPOZITAVE TË BALASTIT TË VEÇUAR NË ANIJET CISTERNË TË NAFTËS

Miratuar me urdhrin nr.____,
datë ___.___._____
të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që Republika e Shqipërisë të marrë përsipër të zbatojë rezolutën e IMO-s A.747(18), për:

[1] Kjo rregullore përafron në mënyrë të plotë Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2978/94, datë 21 nëntor 1994, "Për zbatimin e rezolutës së IMO-s A.747(18): Për matjen e tonazhit të hapësirave të balastit në anijet cisternë të naftës me balast të veçuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr. L 319/1, datë 12. 12. 94, me CELEX: 31994R2978.

2. a) matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë të naftës, të miratuar nga Asambleja e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), më 4 nëntor 1993, shtojca e së cilës është bashkëlidhur kësaj rregulloreje, me qëllim nxitjen e përdorimin e anijeve cisternë të naftës me depozita balasti të veçuar, duke përfshirë anijet cisternë të naftës, me mure të dyfishta dhe anijet cisternë të naftës me projektim alternativ;

3. b) skemat e reduktimit për taksat e vendosura nga autoritetet portuale dhe të pilotimit mbi anijet cisternë për naftë, me balast të veçuar.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për anijet cisternë të naftës, të cilat:

a) mund të mbajnë balast të veçuar në depozita të posaçme;

b) janë projektuar, përshtatur, pajisur dhe operohen si anije cisternë të naftës me balast të veçuar, duke përfshirë anijet cisternë të naftës me mure të dyfishta dhe anijet cisternë të naftës me projektim alternativ;

c) plotësojnë kërkesat e Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve të vitit 1969, dhe janë të pajisura me certifikatën ndërkombëtare të tonazhit (1969).

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "**Anije cisternë për naftë**" është një anije që përputhet me përkufizimin e një anijeje cisternë për naftë në rregulloren 1 (4) të shtojcës 1 të Marpol 73/78.

2. "**Balast i veçuar**" është balasti që përputhet me përkufizimin e balastit të veçuar në rregulloren 1 (17) të shtojcës 7 të Marpol 73/78.

3. "**Depozitë e balastit të veçuar**" është një depozitë që përdoret vetëm për mbajtjen e balastit të veçuar.

4. "**Anije cisternë me balast të veçuar**" është një anije cisternë për naftë e pajisur me depozita balasti të veçuar dhe e certifikuar nga organi kompetent i shtetit shqiptar, si një anije cisternë për naftë e pajisur me depozita balasti të veçuar. Kjo përputhshmëri duhet të deklarohet qartë nga ky autoritet në paragrafin përkatës të shtojcës së certifikatës ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga nafta.

5. "**Anije cisternë me mure të dyfishta**" është një anije cisternë për naftë me balast të veçuar, e ndërtuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren 13F (3) të shtojcës I të Marpol 73/78.

6. "**Anije cisternë për naftë me projektim alternativ**" është një anije cisternë për naftë me balast të veçuar, e ndërtuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren 13 F (4) dhe (5) të shtojcës 1 të Marpol 73/78.

7. "**Marpol 73/78"** është Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet e vitit 1973, e ndryshuar me protokollin e vitit 1978 lidhur me të, ratifikuar nga RSH-ja me ligjin nr. 9594, datë 27.7.2006, së bashku me ndryshimet e saj në fuqi në datën e miratimit të këtij urdhri.

8. "**Autoritet portual**" është një subjekt publik ose privat, i cili vendos tarifa mbi anijet në këmbim të vënies në dispozicion të objekteve dhe shërbimeve për anijet.

9. "**Autoritet pilotazhi**" është një subjekt publik ose privat, i cili ka të drejtë të ofrojë shërbime pilotazhi për anijet.

10. "**Tonazhi bruto**" është madhësia e përgjithshme e një anijeje, e përcaktuar në përputhje me dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969, ratifikuar nga RSH-ja me ligjin nr. 8989, datë 23.1.2003.

11. "**Tonazhi i reduktuar bruto**" është tonazhi bruto i një anijeje cisternë për naftë, i cili përftohet kur tonazhi bruto i depozitave të balastit të veçuar, i përcaktuar në përputhje me formulën e dhënë në paragrafin 4 të shtojcës I të kësaj rregulloreje, zbritet nga totali i tonazhit bruto të mjetit të lundrimit.

12. "Rregulla" nënkupton rregullat e bashkëngjitura kësaj rregulloreje.

13. "Administrata" nënkupton Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë.

14. "Udhëtim ndërkombëtar" nënkupton udhëtim detar në një vend tjetër ku aplikohet Konventa Ndërkombëtare mbi Matjen e Tonazhit të Anijeve, 1969, ose e kundërta.

15. "Tonazhi bruto" nënkupton matjen e masës së madhësisë së përgjithshme të anijes, e vendosur në përputhje me Konventën ekzistuese.

16. "Tonazhi neto" nënkupton matjen e masës së kapacitetit të përdorshëm të një anijeje në përputhje me Konventën ekzistuese.

17. "Anije e re" nënkupton një anije, fundi i së cilës është ndërtuar, ose është në të njëjtën fazë ndërtimi, para ose pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

18. "Anije ekzistuese" nënkupton një anije, e cila nuk është anije e re.

19. "Gjatësia" nënkupton 96 për qind të gjatësisë totale në një nivel uji në 85 për qind të thellësisë së formuar të matur nga maja e kilit (fundit të anijes), ose gjatësia nga ana e përparme e bashit deri tek aksi i boshtit të timonit mbi atë vijë uji, nëse ajo është më e madhe. Në anijet e projektuara me një fund të pjerrët, vija e ujit mbi të cilën kjo gjatësi do të matet duhet të jetë paralele me vijën e përcaktuar të ujit.

20. "Organizatë" nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO).

21. "Konventa" nënkupton Konventën Ndërkombëtare mbi Matjen e Tonazhit të Anijeve, 1969.

Neni 4
Përjashtimet

Kjo rregullore nuk zbatohet, për:
a) anijet e luftës;
b) anijet më të vogla se 24 metra në gjatësi.

Neni 5
Përcaktimi i tonazheve

1. Përcaktimi i tonazheve bruto dhe neto për anijet cisternë të naftës do të kryhet nga Administrata Detare Shqiptare ose ia beson këtë përcaktim organizatave të njohura nga ajo.

2. Në çdo rast, Administrata Detare pranon përgjegjësinë e plotë për përcaktimin e tonazheve bruto dhe neto.

Neni 6
Certifikata ndërkombëtare e tonazhit për anijet cisternë

1. Kur lëshohet certifikata ndërkombëtare e tonazhit (1969) për një anije cisternë me balast të veçuar, e cila i është nënshtruar matjeve në përputhje me rregullat e Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969, organi kompetent vendos nën titullin **"Shënime**", për qëllime të kësaj rregulloreje, një deklaratë në përputhje me paragrafin 3 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, ku specifikohet, se:

a) tonazhi i depozitave të balastit të veçuar të anijes llogaritet në përputhje me metodën dhe procedurën e përcaktuar në paragrafin 4 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje;

b) tonazhi i reduktuar bruto i mjetit të lundrimit.

Neni 7
Tarifa

1. Gjatë llogaritjes së tarifave për anijet cisternë për naftë, të bazuara plotësisht ose pjesërisht te shifra e tonazhit bruto (TB) të mjetit të lundrimit, autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit përjashtojnë tonazhin e depozitave të balastit të veçuar të një anijeje cisternë për naftë, në mënyrë që llogaritjet e tyre të bazohen në tonazhin e reduktuar bruto të treguar nën titullin "Shënime" të certifikatës ndërkombëtare të tonazhit (1969) të mjetit lundrues.

2. Në mënyrë alternative, autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit, garantojnë që tarifa për një anije cisternë për naftë, që përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje, siç parashikohet në nenin 2, të jetë të paktën 17 % më e ulët se tarifa për një anije cisternë pa depozita me balast të veçuar me të njëjtin tonazh bruto.

Autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit do të zbatojnë tashmë një sistem tarifash fikse, siç parashikohet në paragrafin e dytë të këtij neni, por bazuar në një përqindje më të ulët, duke vendosur si minimum shifrën prej 17% mbas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Kur tarifat llogariten mbi një bazë të ndryshme nga tonazhi bruto, autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit, garantojnë që anijet cisternë për naftë me balast të veçuar të mos

marrin trajtim më pak të favorshëm se sa kur tarifat llogariten në përputhje me paragrafin 1 ose 2.

4. Autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit zbatojnë, për të gjitha anijet cisternë për naftë me balast të veçuar, vetëm një prej sistemeve të përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3.

Neni 8
Parashikime të fundit

1. Ministria përgjegjëse për transportin, miraton dispozitat administrative që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Dispozitat administrative mbulojnë, ndër të tjera, organizimin, procedurën dhe mjetet e kontrollit.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare i dërgon ministrit përgjegjës për transportin çdo vit të gjithë informacionin e disponueshëm lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje, duke përfshirë shkeljet e konstatuara nga autoritetet portuale dhe ato të shërbimeve portuale.

3. Ministria përgjegjëse në fushën e transportit detar i komunikon organeve kompetente për këtë qëllim, të gjitha dispozitat e legjislacionit të brendshëm shqiptar që miratohen në fushën që rregullohet nga kjo rregullore.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare .

SHTOJCË 1
MATJA E TONAZHIT TË DEPOZITAVE TË BALASTIT TË VEÇUAR NË ANIJET CISTERNË PËR NAFTË

Për të përdorur një bazë të unifikuar për matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë për naftë, administratat, organet e njohura për lëshimin e certifikatave ndërkombëtare dhe personat që taksojnë anijet cisternë për naftë pranojnë parimet e mëposhtme:

1. Anija është certifikuar si anije cisternë për naftë me balast të veçuar, siç parashikohet në paragrafin 5 të shtojcës së certifikatës ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga nafta, dhe vendndodhja e depozitave të balastit të veçuar tregohet në paragrafin 5.2 të shtojcës.

2. Depozitat me balast të veçuar janë ato depozita që përdoren ekskluzivisht për mbajtjen e ujit të balastit të veçuar, siç përcaktohet në rregulloren 1 (17) të shtojcës I të Marpol 73/78. Depozitat e balastit të veçuar duhet të jenë të pajisura me një sistem të veçantë pompash dhe tubacionesh vetëm për marrjen e ujit të balastit nga deti dhe shkarkimin e tij në det. Nuk duhet të ketë asnjë tubacion që lidh depozitat e balastit të veçuar me sistemin e ujërave të ëmbla. Asnjë depozitë me balast të veçuar nuk duhet të përdoret për transportin e ngarkesave apo për magazinimin e rezervave apo materialeve të anijes.

3. Në certifikatën ndërkombëtare të tonazhit (1969) nën titullin "Shënime" vendoset shënimi i mëposhtëm për tonazhin e depozitave me balast të veçuar në anijet cisternë për naftë:

a) "Depozitat e balastit të veçuar janë në përputhje me rregulloren 13 të shtojcës I të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet të vitit 1973, të ndryshuar nga protokolli i vitit 1978, që lidhet me të, dhe tonazhi total i këtyre depozitave që përdoren ekskluzivisht për mbajtjen e ujit të veçuar të balastit është...

b) Tonazhi i reduktuar bruto, i cili duhet të përdoret për llogaritjen e tarifave të bazuara në tonazh është...".

4. Tonazhi i depozitave të balastit të veçuar i përmendur më sipër llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$K_1 \times V_b$

Ku:

$K_1 = 0{,}2 + 0{,}02 \log 10\ V$ (ose siç tregohet në shtojcën 2 të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969).

V = vëllimi total i të gjitha hapësirave të mbyllura të anijes në metër kub, siç përcaktohet në rregulloren 3 të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969.

V_b = vëllimi total i depozitave me balast të veçuar në metër kub, i matur në përputhje me rregulloren 6 të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969.

SHTOJCË 2
PËRKUFIZIMET E DHËNA NGA MARPOL 73/78 PËR TERMAT E NENIT 3, PARAGRAFI 1, GERMAT "A", "G", "C" DHE "D"

Paragrafi 1, germa "a":

"Anije cisternë për naftë" është një anije e ndërtuar ose e përshtatur kryesisht për të transportuar naftë në sasi të mëdha në hapësirat e saj për ngarkesa, dhe përfshin anijet për transportin e ngarkesave të kombinuara dhe "anijet cisternë për substanca kimike" sipas përkufizimit në shtojcën II të Konventës Ndërkombëtare të Tonazhit, kur ngarkesa e transportuar prej tyre apo një pjesë e saj përmban naftë në sasi të mëdha.

"Anije për transportin e ngarkesave të kombinuara" është një anije e projektuar për të transportuar ngarkesa nafte ose të ngurta në sasi të mëdha.

"Anije cisternë për substanca kimike" është një anije e ndërtuar ose e përshtatur kryesisht për të transportuar ngarkesa me substanca të lëngshme të dëmshme në sasi të mëdha, dhe përfshin "anijet cisternë për naftë" sipas përkufizimit në shtojcën I të Konventës Ndërkombëtare të Tonazhit, ngarkesa e transportuar prej tyre apo një pjesë e saj përmban substanca të lëngshme të dëmshme në sasi të mëdha.

Paragrafi 1, germa "g":

"Balast i veçuar" është uji i balastit, i futur në një depozitë, e cila është tërësisht e veçuar nga sistemet e ngarkesës së naftës dhe të lëndës djegëse të lëngshme për konsum, dhe e cila ka si destinacion të përhershëm transportin e balastit ose të ngarkesave të ndryshme nga nafta ose substancat e dëmshme, sipas përkufizimeve të ndryshme të dhëna në shtojcat e Konventës.

Paragrafi 1, germa "c":

"Anije cisternë për naftë me mure të dyfishta" është një anije cisternë për naftë në të cilën depozita e ngarkesës është e mbrojtur në të gjithë gjatësinë e saj nga depozita balasti ose hapësira të ndryshme nga depozitat e ngarkesave dhe të lëndës djegëse të lëngshme.

Paragrafi 1, germa "d":

"Anije cisternë për naftë me projektim alternativ", është:

- një anije cisternë për naftë, projektimi i së cilës është i tillë që presioni i ngarkesës dhe i avujve, i ushtruar mbi pjesën e poshtme të jashtme të skafit, e cila përbën të vetmen shtresë ndarëse midis ngarkesës dhe detit, nuk tejkalon presionin e jashtëm hidrostatik të ujit;

- një anije cisternë për naftë që është projektuar sipas metodave që sigurojnë të paktën të njëjtin nivel mbrojtjeje ndaj ndotjes nga nafta në rast përplasjeje ose bllokimi dhe që janë miratuar në parim nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar, bazuar në udhëzimet e hartuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare.

URDHËR
Nr. 697, datë 22.10.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat"; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si më poshtë:

a) kontratat e lidhura nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në cilësinë e botuesit me autorët e botimeve, do të nënshkruhen nga drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen deri në një urdhër të dytë.

3. Në rast të mungesës së personit të përcaktuar në këtë urdhër, kompetencat do të ushtrohen vetëm nga drejtori i Përgjithshëm.

4. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

URDHËR
Nr. 925, datë 29.10.2021

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT TË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATË
(Në sistemin elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS)

Në zbatim të nenit 4/2, nenit 21 dhe nenit 42/2, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshua, dhe me ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë "Deklaratë periodike vjetore për subjekte në funksion", bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.ildkpki.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË PERIODIKE VJETORE NË FORMAT ELEKTRONIK PËR SUBJEKTE NË FUNKSION

Nr. Indeksi në ILDKPKI dhe Viti	

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave privatë të tij, të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014, me Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017 dhe Ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Emri	Atësia	Mbiemri

Funksioni

Institucioni dhe adresa

Data e emërimit në funksionin që kryen	Data e dorëzimit të deklaratës

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.
Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

TË DHËNA PERSONALE TË SUBJEKTIT DHE PERSONAVE TË LIDHUR

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:
(Njësia Administrative Nr. , Rruga, Pallati nr., Bashki/Komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni:	

Rrethi i personave të lidhur me subjektin, në funksion të kufizimit të interesave privatë për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trungut familjar) dhe prindërit e subjektit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetusit/es.

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					Babai i deklaruesit	
					Nëna e deklaruesit	
					Babai i bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					Nëna e bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es	
					I biri/e bija e ndarë nga prindërit	
					Bashkëjetuesi/ Bashkëjetuesja	

Të dhënat në këtë faqe janë konfidenciale.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

DEKLARIMI I PASURIVE
DHE
BURIMI I KRIJIMIT

Përshkruani hollësisht të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite sipas gërmës a, b, c, ç, d të nenit 4, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndyshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil, tuaja dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë, gjendje më dt. 31.12.2021, në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

"Periodik Vjetor për Subjekte në Funksion" 3

TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021.

Përshkruani hollësisht të ardhurat, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, si dhe detyrimet e lindura për subjektin, gjatë vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor 2021 (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor 2021. (Principal)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshem (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për shpenzimet e deklarueshme janë fusha konfidenciale.

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma në lekë ose valutë të huaj

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

DHURATA DHE TRAJTIME PREFERENCIALE

Përshkruani hollësisht llojin e dhuratës në vlerën mbi 10 000 (dhjetë mijë lekë), si dhe trajtime preferenciale, nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik. Të dhënat për dhuratat dhe trajtimet preferenciale janë fusha konfidenciale.	Identiteti i personit fizik ose juridik dhe lidhja e tij me zyrtarin.	Vlera e dhuratës /trajtimit preferencial në lekë ose valutë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE PERSONAT E BESUAR

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me zyrtarin që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: www.ildkpki.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi në ILDKPKI	

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur me subjektin deklarues (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë "*, i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja _____,
Emër, Atësi, Mbiemër

bashkëshorti/ja ☐
fëmijë madhorë së bashku me prindërit ☐
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit ☐
bashkëjetuesi/ja ☐

i/e Subjektit _____.
Emër, Atësi, Mbiemër

Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim/Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

DEKLARIMI I PASURIVE
DHE BURIMI I KRIJIMIT

Përshkruani hollësisht të gjitha pasuritë e akumuluara ndër vite, sipas gërmës a, b, c, ç, d të nenit 4, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndyshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale sipas Kodit Civil, tuaja dhe/ose në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë, gjendje më 31.12.2021 në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumën e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

***Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021.

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri më 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor 2021 (Principal + interes)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (Principal)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë, si për arsim, mjekim, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm (i fundit) deri në 31 dhjetor 2021, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për shpenzimet e deklarueshme janë fusha konfidenciale.

Përshkrimi i shpenzimeve	Shuma në lekë ose valutë të huaj

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE PERSONAT E BESUAR

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me personin e lidhur që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.
Të dhënat për personat e besuar janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave privatë, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar
- Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, i ndryshuar.

Deklarimi i interesave privatë, periodike vjetore në formë elektronike, për subjekte në funksion, gjendje më dt. 31.12.2021, duhet të plotësohet në sistemin elektronik online EACIDS nga zyrtari (subjekt deklarues) në funksion apo në detyrë më dt. 31.12.2021 dhe personat e lidhur me të.

- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit, gjendje më dt. 31.12.2021.
  (Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë periodike vjetore në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluara ndër vite dhe detyrimet financiare, që janë **gjendje në dt. 31.12.2021**, si dhe burimin e krijimit të tyre).
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- **Deklarata e interesave privatë, periodike vjetore, në formë elektronike për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës 31 mars 2022, si vijon:**
  - **në formë elektronike,** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
  - **në formë shkresore,** në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

Deklarimi i interesave privatë, periodike vjetore, në formë elektronike, për subjekte në funksion, gjendje më dt. 31.12.2021, duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, **për pasuritë që disponojnë veçmas,** dhe plotësojnë formularin përkatës, si vijon;

- **në formë elektronike,** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
- **në formë shkresore,** në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave privatë të personave të lidhur.

Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.
  Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.
- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inpektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, info@hidaa.gov.al.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.

Shënim: Ky formular i deklarimit plotësohet vetëm një herë, për pasuritë e akumuluara ndër vite dhe dorëzohet në autoritetin përgjegjës të institucionit publik, brenda datës 31 mars 2022.

URDHËR
Nr. 926, datë 29.10.2021

PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË
(Në sistemin elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS)

Në zbatim të nenit 4/2, të nenit 21 dhe të nenit 42/2, të ligjit nr. 9049, datë 7.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018;

URDHËROJ:

1. Miratimit e formularëve të deklarimit të interesave privatë, bashkëlidhur këtij urdhri:
- Deklaratë e interesave privatë "Para fillimit të detyrës";
- Deklaratë e interesave privatë "Periodike/ vjetore";
- Deklaratë e interesave privatë "Pas largimit nga funksioni";
- Deklaratë e interesave privatë "Me kërkesë";
- Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

2. Urdhri i inspektorit të Përgjithshëm nr. 223, datë 9.5.2017, "Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave privatë", shfuqizohet.

3. Urdhri i inspektorit të Përgjithshëm nr. 284, datë 9.5.2017, "Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave privatë (për kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë)", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website:www.ildkpki.al, E-mail: info@hidaa.gov.al

Nr. Indeksi	
në ILDKPKI	
dhe Viti	

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATË PARA FILLIMIT TË DETYRËS

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim të interesave privatë të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014, Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017, dhe Ligjin nr. 105/2018, datë 13.12.2018.

A U T O R I Z I M
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË

Emri	Atësia	Mbiemri

Funksioni

Institucioni dhe adresa

Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar,

A u t o r i z o j:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, që të verifikojnë në të gjitha subjektet privatë e publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.
Jap pëlqimin për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave – EACIDS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

TË DHËNA PERSONALE TË SUBJEKTIT DHE PERSONAVE TË LIDHUR

PËRBËRJA FAMILJARE E SUBJEKTIT SIPAS CERTIFIKATËS SË GJENDJES CIVILE

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Nr.Personal	Lidhja me deklaruesin	Gjendja Civile
					DEKLARUESI	

Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në Gjendjen Civile:
(Njësia Administrative Nr. , Rruga, Pallati Nr., Bashki/Komunë)

Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni:	

Rrethi i personave të lidhur me subjektin, në funksion të kufizimit të interesave privatë për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm janë: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore (brenda ose jashtë trungut familjar) dhe prindërit e subjektit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera	Pjesa në %

***Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

* **Neni 4/1.** Personi i lidhur që plotëson këtë deklarim nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë është i detyrueshëm, përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë në ILDKPKI.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë
13

ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimiprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave privatë të personit të lidhur nga gjaku apo martesa, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëtin vendbanim me kandidatin për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave privatë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë
14

DETYRIMET FINANCIARE
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave privatë, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik. Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur me kandidatin ka detyrime financiare, janë fusha konfidenciale.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave privatë

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë
15

PERSONAT FIZIKË/JURIDIKË DHE PERSONAT E BESUAR

Të dhënat për personat fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me personin e lidhur që mbart detyrimin për deklarim, në përputhje me fushat e përcaktuara në sistemin elektronik.

Të dhënat për shpenzimet e deklarueshme janë fusha konfidenciale.

Emër, Atësi, Mbiemër i personit fizik dhe /ose emërtimi i personit juridik	Lidhja me deklaruesin	Lloji i interesave privatë, vendndodhja e tyre.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë
16

Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe personave të lidhur me të, bazohet në ligjet:

- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 76/2016 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"*, i ndyshuar;
- Ligji nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*;
- Ligji nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";*
- Ligji nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".*

Deklarata e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

- Dokumenti zyrtar **"Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë"**, të plotësohet nga kandidatët e përcaktuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar.
- Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, deklarimi përfshin interesat privatë të kandidatit, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, si dhe burimet e krijimit të tyre deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë.
- Data e dorëzimit, e shënuar në faqen nr.1, të deklaratës së interesave privatë, duhet të përputhet me gjendjen e të dhënave të deklaruara në faqet e tjera të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë.
- **"Deklarata e interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë", duhet plotësuar dhe dorëzuar në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si më poshtë vijon;**
  - **<u>në formë elektronike,</u>** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
  - **<u>në formë shkresore</u>**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.
- Në pikën 4 të nenit 4/2 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar, përcaktohet se:
  Subjektet (kandidatët), të cilët nuk janë zyrtarë në momentin e dorëzimit të deklaratës, e dorëzojnë atë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas përcaktimeve të këtij neni, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.

- Kur pasuria e personave të lidhur, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur me pasuri të regjistruar veçmas dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim. Pasuria është e detyrueshme për deklarim edhe në rastet kur është e pa regjistruar në regjistrat publikë dhe privatë.

Deklarimi i pasurisë dhe interesave privatë nga personi i lidhur me kandidatin për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

- Dokumenti zyrtar *"Deklarata e pasurisë dhe interesave privatë e personit të lidhur"* duhet të plotësohet nga personat e lidhur (***bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore***), të cilët mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, për pasuritë që disponojnë veçmas, **në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si më poshtë vijon;**

- **<u>në formë elektronike,</u>** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
- **<u>në formë shkresore</u>**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse.

▪ Kandidati nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave privatë të personave të lidhur.

Nëse keni persona të lidhur nga gjaku apo martesa, që banojnë me ju më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë përkatëse në këtë formular, i cili plotësohet vetëm nga personat e lidhur me kandidatët që shprehin interesa për:

1. gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar,
2. prokurorë, oficerë hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit.

▪ Dokumenti zyrtar *"Deklarata e pasurisë dhe interesave privatë e personit të lidhur"* duhet të plotësohet nga personat e lidhur me kandidatin ***me lidhje gjaku apo martese, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim***, për pasuritë që disponojnë veçmas, **në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si më poshtë vijon;**
- **<u>në formë elektronike,</u>** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI, dhe;
- **<u>në formë shkresore</u>**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse.

▪ Kandidati nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave privatë të personave të lidhur.

Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen (përkatësisht) nga deklaruesi dhe personat e lidhur me të, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

Kandidati dhe personat e lidhur me të, duhet t'a shoqërojnë deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë me të gjithë dokumentat shoqëruese të nevojshme për të provuar vërtetësinë e deklarimeve në sasi dhe në vlerë, për ligjshmërinë dhe burimin e krijimit të interesave privatë (të pasurive, të detyrimeve financiare, të ardhurave).
Bashkëlidhur modeli i inventarit të dokumentacionit justifikues/shoqërues të deklaratës së pasurisë.

Sanksionet:

▪ Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"*, i ndryshuar.
▪ Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive dhe interesave privatë, përbën vepër penale dhe dënohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal.
▪ Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inpektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461**, Free. 08009999, info@hidaa.gov.al.
▪ Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.

I N V E N T A R

I dokumentacionit justifikues / shoqërues
të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit

_____

NR	Përshkrimi i Dokumentit	Origjinal	Noterizuar	Fotokopje	Nr.Fletëve
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					

TOTAL _____ **fletë**

Datë_____/____/_____

Dorëzuesi **Marrësi në dorëzim**

_____ _____

Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë
19

UDHËZIM
Nr. 927, datë 1.11.2021

PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATAVE TË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATË NË FORMË ELEKTRONIKE NË SISTEMIN ELEKTRONIK PËR DEKLARIMIN E PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT (EACIDS)

Në mbështetje të nenit 4/2, nenit 15, nenit 16/1, nenit 17, 21, 22, 34/2 dhe nenit 42/2, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore 'Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS'",

UDHËZON:

I. Preambulë

1. Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – (EACIDS) është një sistem informacioni, i zhvilluar për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë dhe konfliktit të interesit nga subjektet që mbartin detyrim për deklarim, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky sistem menaxhon regjistrin e autoriteteve përgjegjëse, regjistrin e subjekteve deklaruese dhe personave të lidhur, deklaratat e interesave privatë, si dhe proceset e brendshme të punës në ILDKPKI, në lidhje me administrimin e deklaratave të dorëzuara, verifikimin dhe kontrollin e saktësisë së të dhënave të deklaruara, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

II. Subjektet ndërvepruese me bazën e të dhënave EACIDS

2. Përdoruesit që do të ndërveprojnë me sistemin EACIDS, për të paraqitur dhe/ose për të administruar të dhënat, janë:

a) ILDKPKI-ja;

b) autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike;

c) subjektet deklaruese, që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë në ILDKPKI;

d) institucionet publike dhe private për dhënie informacioni në funksion të kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ.

3. ILDKPKI-ja është përgjegjës për krijimin, mirëmbajtjen, administrimin e bazës së të dhënave "Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit — EACIDS", dhe për ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit.

4. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në çdo institucion publik është struktura përgjegjëse, e cila ndjek në vazhdimësi procesin e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë, për të gjithë zyrtarët e institucionit publik përkatës, duke hartuar dhe përditësuar listën e zyrtarëve, të cilët në varësi të funksionit që kryejnë, mbartin detyrimin për deklarim të interesave privatë. Autoriteti përgjegjës menaxhon procesin e deklarimit në sistem të subjekteve deklaruese, sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij udhëzimi.

5. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave ushtron këto funksione dhe detyra në përdorimin e sistemit:

a) krijon llogarinë fillestare dhe/ose menaxhon llogaritë e subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim të interesave privatë në institucionin përkatës;

b) menaxhon tipin e deklaratave që duhet të plotësojë subjekti deklarues;

c) rivendos fjalëkalimin për çdo subjekt deklarues kur është e nevojshme ose me kërkesë të subjektit deklarues;

ç) realizon çaktivizimin e llogarisë së subjektit deklarues, në të cilën subjekti e ruan aksesin, por vetëm në variantin e lexueshëm;

d) përgatit raporte të përgjithshme vjetore për subjektet deklaruese gjatë vitit kalendarik me të dhëna statistikore, si dhe sa herë kërkohet një gjë e tillë nga inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së;

dh) menaxhon deklarimin elektronik të konfliktit të interesit;

e) ndihmon kryesisht ose sa herë që i kërkohet nga subjektet deklaruese, për deklarimin e plotë dhe korrekt në sistem të pasurisë dhe konfliktit të

interesave të subjekteve deklaruese, si dhe bashkëpunon ngushtësisht me ILDKPKI-në për realizimin me sukses të këtij procesi;

ë) përditëson (shton/fshin/çaktivizon) listën e funksioneve që kanë detyrim për deklarim të interesave privatë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

6. Kryerja e detyrave të autoritetit përgjegjës, sipas përcaktimeve të seksionit III, të këtij udhëzimi, në lidhje me procedurën e deklarimit, bëhet në përputhje me manualet përkatës të përdorimit të sistemit elektronik të deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave (EACIDS), të cilët janë pjesë integrale e këtij udhëzimi, si dhe me çdo udhëzim tjetër të dhënë nga inspektori i përgjithshëm.

7. Subjektet deklaruese:

a) menaxhojnë llogaritë e tyre në sistemin EACIDS;

b) mbajnë përgjegjësi për aprovimin e versionit përfundimtar brenda afateve të përcaktuara në ligj e në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe përcaktimet e këtij udhëzimi;

c) dorëzojnë të nënshkruar, në formë shkresore, deklaratën e interesave privatë të përfunduar pranë autoriteteve përgjegjëse;

ç) bashkëpunojnë e konsultohen me autoritetin përgjegjës në lidhje me procedurën e deklarimit në sistemin EACIDS;

d) bashkëpunojnë me ILDKPKI-në, gjatë procedurave të kontrollit të plotë dhe/ose hetimit administrativ.

8. Subjektet deklaruese duhet të plotësojnë deklaratat e interesave privatë përkatëse, sipas mënyrës dhe afateve të mëposhtme:

a) Subjektet, të cilat mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë periodike vjetore në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluara ndër vite dhe detyrimet financiare me gjendje **më 31.12.2021**, si dhe burimin e krijimit të tyre. Deklarata e interesave privatë periodike vjetore në formë elektronike, për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës **31 mars 2022**, si vijon:

- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; dhe

- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

b) Subjektet të cilët fillojnë marrëdhëniet e punës pas datës 1 janar 2022, mbartin detyrimin të bëjnë deklarimin para fillimit të detyrës dhe duhet të kryejnë deklarimin në sistemin elektronik EACIDS, brenda 30 ditëve nga fillimi i detyrës, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:

- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; dhe

- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

c) Subjektet, të cilat mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave, duhet të kryejnë deklarimin në sistemin EACIDS, brenda datës **31 mars të çdo viti**, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:

- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; dhe

- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

d) Subjektet të cilët largohen nga detyra pas datës 1 janar 2022, mbartin detyrimin të bëjnë deklarimin pas largimit nga funksioni dhe duhet të kryejnë deklarimin në sistemin elektronik EACIDS, brenda 15 ditëve nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj, si vijon:

- **në formë elektronike**, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të

deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; dhe

- **në formë shkresore**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.

e) Kandidatët, që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë dhe interesave privatë për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, duhet të plotësojnë deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si më poshtë vijon:

- **në formë elektronike,** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; dhe

- **në formë shkresore,** në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik, apo nëse parashikohet në ligj pranë ILDKPKI-së.

f) Subjektet, të cilat mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin me kërkesë të interesave privatë, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë me kërkesë, në formë elektronike, në sistemin EACIDS, jo më vonë se 30 ditë nga data që inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së kërkon kryerjen e deklarimit me kërkesë, në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore në fuqi, si vijon:

- **në formë elektronike,** duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; dhe

- **në formë shkresore,** në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

III. Procedura e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë nëpërmjet bazës së të dhënave EACIDS

9. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave regjistron në sistemin EACIDS të dhënat e subjektit deklarues dhe personave të lidhur me të, në përputhje me fushat e kërkuara dhe mënyrës së përcaktuar në manualet e përdorimit të sistemit.

10. Me regjistrimin e zyrtarit si subjekt deklarues, sipas pikës 5 të udhëzimit, në sistemin EACIDS krijohet llogaria e tij, duke i gjeneruar emër përdoruesi dhe fjalëkalim.

11. Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave njofton me shkresë zyrtare subjektin deklarues për llogarinë e hapur brenda 48 orëve nga krijimi i saj, duke i komunikuar emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që duhet të përdorë në llogarinë e tij.

12. Subjekti deklarues, krahas njoftimit me shkresë sipas pikës 11, merr njëkohësisht edhe një komunikim elektronik (*email*) në adresën e njoftuar prej tij/saj, pranë autoritetit përgjegjës, në të cilin i komunikohet emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi i llogarisë, me të cilat kryen hyrjen e parë në sistemin EACIDS.

13. Subjekti deklarues, që kryen hyrjen për herë të parë në llogarinë e tij në sistemin EACIDS, duhet të bëjë ndryshimin e fjalëkalimit të dhënë me një fjalëkalim të zgjedhur prej tij. Fjalëkalimi duhet të jetë minimalisht me 6 karaktere, si dhe duhet të përmbajë një kombinim të shkronjave kapitale dhe të vogla, numrave dhe karaktereve speciale, si: (! , @, #, etj.);

14. Plotësimi, ndryshimi, korrigjimi i llojit të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, dhe në përgjithësi menaxhimi i llogarisë së subjektit deklarues, bëhet elektronikisht dhe është përgjegjësi e vetë subjektit deklarues. Veprimet e përshkruara në këtë pikë mund të kryhen për sa kohë subjektet nuk kanë aprovuar versionin përfundimtar të deklaratës në sistemin elektronik. Pas aprovimit të versionit përfundimtar subjekti mund të aksesojë vetëm variantin e lexueshëm dhe nuk mund të kryejë më veprime mbi deklaratën e dorëzuar në mënyrë elektronike.

15. Deklarata e interesave privatë e përfunduar nëpërmjet sistemit elektronik, nuk do të konsiderohet e dorëzuar me aprovimin e versionit përfundimtar dhe ngarkimin në sistemin elektronik

EACIDS. Subjektet deklaruese, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, për çdo vit bëjnë dorëzimin e deklarimit periodik vjetor, dhe kur është rasti, deklarimin para fillimit të detyrës, deklarimin pas largimit nga funksioni, deklarimin me kërkesë dhe deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, duke e printuar, nënshkruar në çdo faqe dhe dorëzuar në formë shkresore në autoritetin përgjegjës të parandalimit të konfliktit të interesave, sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

IV. Dispozita të fundit

16. Autoritetet përgjegjëse duhet të kryejnë në mënyrë efektive detyrat e tyre sipas dispozitave ligjore në fuqi, këtij udhëzimi, si dhe manualeve për përdorimin e sistemit EACIDS, që janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.

17. Nëse autoritetet përgjegjëse në kohën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi kanë në përbërje të tyre vetëm një nëpunës dhe kur numri i subjekteve deklaruese në këtë institucion është më i madh se 50 subjekte, titullari i institucionit brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, emëron me shkrim, në detyrën e nëpunësit të dytë të autoritetit përgjegjës, një punonjës pjesë të drejtorisë/sektorit të burimeve njerëzore ose, në mungesë, një punonjës tjetër të institucionit me formim jurist.

18. Një kopje e urdhrit të titullarit të institucionit për emërimin e nëpunësit, sipas pikës 17 të këtij udhëzimi, i dërgohet ILDKPKI-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari

NJOFTIM
Nr. 15576, datë 1.11.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Federatës së Shën Kristoferit (St. Kitts) dhe Nevis, për përjashtimin e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të zakonshme, nënshkruar më 14.5.2019, ka hyrë në fuqi më 29 tetor 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

ARGUMENTET E VOTËS "KUNDËR" PËR AKTIN "PËR MIRATIMIN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021", TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT RREGULLATOR

Në rrethanat kur, mendimi dhe qëndrimi i dy anëtarëve të Komisionit Rregullator nuk pajtohet me qëndrimin dhe vullnetin e tre anëtarëve të tjerë të Komisionit Rregullator, në lidhje me vendimin "Për miratimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021", rendisim mendimin dhe argumentet mbi të cilat mbështetet qëndrimi i dy anëtarëve, duke e konsideruar atë edhe si shprehje vullneti "kundër" miratimit në parim dhe në tërësi të aktit të mësipërm.

Për sa më sipër, sipas anëtares së Komisionit Rregullator, znj. Helga Vukaj, renditen argumentet, si vijon:

së pari, theksojmë se procesi i normimit të akteve për përgatitjen e zgjedhjeve ishte një proces i vrullshëm dhe intensiv. Ai përvijoi prej muajve të tërë, me një gamë të gjerë aktesh, me një gamë të gjerë diskutimi, debati etj. Sot kemi në tryezë për shqyrtim dhe miratim aktin final të formalizimit, të përmbylljes së procesit zgjedhor. Vërtet ky akt i përgatitur nga administrata, në dukje ka një përmbajtje në pak rreshta, por në thelb ky akt është pasqyra e pazëllit të tërësisë së akteve të miratuara nga KQZ-ja. Pra, jo vetëm nga ne si Komision

Rregullator, por dhe nga dy organet e tjera. Është efekt i pazëllit, në drejtim të zbatimit dhe të respektimit të tyre nga vetë KQZ-ja, por edhe nga aktorët e përfshirë në këtë proces. Siç e dimë, janë jo vetëm partitë politike, pra subjektet zgjedhore, por njëkohësisht edhe administrata apo institucionet, të cilat u përfshinë në këtë proces;

së dyti, ky akt në pritshmëritë tona në fakt, duhet të ishte gjurma finale e dështmisë së suksesit dhe arritjes së standardeve më të larta të demokracisë në fushën e zgjedhjeve. Po ashtu, duhet të ishte dështmi e respektimit të pandikueshmërisë në shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve. Dështmi e respektimit të detyrimit të mbajtjes larg nga procesi, të administratës, të mosabuzimit me fondet publike, të të mirave publike, aseteve dhe njëkohësisht mosndikimin e pushtetit apo të të ardhurave nga institucionet shtetërore, qendrore apo vendore. Gjithashtu, duhet të ishte edhe dështmi e respektimit në maksimum të parimit të transparencës, me qëllim që procesi të quhej proces i arrirë në kuptimin e Kodit Zgjedhor, por edhe në kuptimin e parimit të ligjshmërisë;

së treti, pa dyshim, që në meritë të integritetit dhe profesionalizmit, jemi përpjekur që përmes diskutimit, debatit të normojmë akte, të cilat në përmbajtje mendoj se ishin progres dhe arritje në fushë. Pavarësisht kësaj, këto akte nuk u zbatuan apo aplikuan siç duhet. Kjo padyshim që ka sjellë sigurisht pasojë në këtë akt, apo në përmbajtjen dhe rezultatin që presim prej tij. Sigurisht ka sjellë edhe ndikim në pritshmërinë për zgjedhje të lira e të ndershme. Kujtoj këtu, aktin për veprimtaritë e ndaluara, i cili u shpërfill tërësisht nga administrata qendrore dhe vendore. Dështmi e qartë, siç e dini sepse jeni dështmitarë, janë kronikat mediatike, faktet e sjella nga subjektet zgjedhore, kallëzimet apo dështmitë e dorëzuara nga subjektet zgjedhore në institucionet ligjzbatuese. Për këtë konstatim të mos shkojmë më larg se Tirana, kemi shembullin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, i cili u bë një subjekt i shkeljes dhe i procesit të verifikimit përmes këtij akti apo më gjerë, por që nuk u ndëshkua kurrë;

së katërti, dua të kujtoj këtu fenomenin e patronazhimit, patronazhimit të "pakërkuar" dhe e theksoj apo e përsëris të "pakërkuar", i cili ndryshon nga të dhënat vullnetare që kërkon të përcjellë çdo zgjedhës pranë partisë ku aderon, pranë partisë ku ka preferencën të çojë votën, apo që simpatizon. Edhe ky fenomen është zbuluar mediatikisht. Përmes këtij fenomeni survejuesi monitoronte dhe merrte të dhëna personale, sociale, familjare për çdo individ, me qëllim ndikimin dhe orientimin e votës drejt partisë në pushtet. Ju e dini mirë rastin e denoncuar nga unë (anëtarja Helga Vukaj), për patronazhistin tim personal dhe trumbetimin që i bëra këtij rasti, jo si ndikim individual, por si ndikim social dhe njëkohësisht si një fenomen, i cili po ndikonte dhe po linte gjurmën më negative në historinë e procesit zgjedhor;

së pesti, dua të kujtoj abuzimin me fondet publike, të raportuara mediatikisht, por njëkohësisht e gjeni këtë konstatim edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it. Kujtojmë shifrën prej 926.000.000 (nëntëqind e njëzetë e gjashtë milionë) lekë, të shpërndara javën e fundit të procesit zgjedhor. Pra, data 25 prill ishte data e cila i paraprinte "qokës", le të themi, të shpërndarë në Prefekturën Durrës qytetarëve, të cilët merrnin një shpërblim të ndryshëm nga ai i targetuar teknikisht, për dëmin që kishin pësuar në vitin 2019, pra dy vite më parë. Pse pikërisht mbas datës 25 ky shpërblim u ndërpre si me thikë? Kjo më çon të mendoj, ashtu si mediat kanë analizuar, nuk shkoj më larg analizës së tyre, për një ndikim absolut në procesin zgjedhor dhe në votën e lirë;

së gjashti, nuk dua të lë pa përmendur punësimet e panumërta, të kryera në shkelje të ligjit dhe të aktit të Komisionit Rregullator - aktit për veprimtaritë e ndaluara, nga pushteti vendor, nga institucionet apo entet shtetërore, në nivel qendror apo vendor. Të cilat nuk na dhanë llogari asnjëherë. Për këtë qëllim, ju kujtoj kërkesën time drejtuar administratës së KQZ-së, për të marrë informacion mbi punësimet e kryera përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

së shtati, dua të kujtoj madje dhe përdorimin e parasë së "pisët" nga parti të cilat pa program dhe pa elektorat thyen çdo rregull të standardeve klasike të funksionimit të garimit politik dhe për më tepër të garimit të ndershëm.

Jemi dështmitarë kolegë, për gjithë sa më sipër, madje dhe i denoncimeve të shumta nga subjektet zgjedhore, partitë politike, pranë organeve të zbatimit të ligjit, prokurorisë, SPAK-ut për të parandaluar sa të ishte e mundur. Personalisht (thekson anëtarja Helga Vukaj), pata një rol aktiv

duke kërkuar përmes administratës sonë t'i drejtohej dhe t'i adresonte Prokurorit të Përgjithshëm kërkesën për informacion, me qëllim incentivimin dhe vënien në lëvizje të prokurorive kompetente për t'i shtyrë në përshpejtim këto raste (kallëzime), me qëllim që të jepnin një efekt para procesit zgjedhor. Kërkova që t'i drejtoheshim edhe SPAK-ut, se çfarë është duke bërë apo çfarë informacioni mund të na përcillte në drejtim të këtyre kallëzimeve, por nuk patëm asnjë përgjigje. Efekti post ndaj këtyre denoncimeve nuk besoj se do të kishte ndonjë ndikim për të arritur drejt një standardi të lartë në këto zgjedhje.

Kam kërkuar, gjithashtu, dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nga drejtuesi i *e-Albania* apo nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, për efektin që do të sillnin apo mënyrën se si u ishin servirur patronazhistëve të dhënat personale, por as këtu nuk mora asnjë përgjigje. Gjithashtu, do të evidentoja mes gjithë kujtesave të tjera edhe masakrën e numëruesve. Në fakt partitë politike nuk reshtën së kontestuari apo i kanë sjellë në vëmendje të organit tonë homolog apo paralel KAS, për t'i shqyrtuar ligjërisht këto raste, por ky i fundit iu shmang parimit të transparencës. Po i referohem rastit të qarkut Gjirokastër, ku Lëvizja Vetëvendosja bëri publike në media, por edhe në KQZ, të gjithë dokumentimin për cenimin e votës me zë dhe me figurë;

së teti, nuk mund të anashkalojmë, për as edhe një moment, faktin që nga organi administrativ (KAS) i verifikimit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor u mohua respektimi i parimit të transparencës, e për rrjedhojë edhe parimi i ligjshmërisë. Lind pyetja: E si mund të flasim për një proces, i cili, në të cilin, ose për të cilin është ruajtur apo respektuar parimi i ligjshmërisë? Në këtë pikë, si mund të mos përmendim sjelljen e trupit gjyqësor të Kolegjit Zgjedhor të Apelimit, në raport me respektimin e ligjit, në kuadër të kërkesës për verifikimin e ligjshmërisë së procesit, nga ana e partive politike. U pa se mungoi tërësisht transparenca, nuk u morën provat e kërkuara nga palët, si rrjedhojë u dëshmua edhe në këtë fazë për mosrespektim të garancisë për një proces të rregullt ligjor dhe objektiv. Si rrjedhojë ai u bë i pabesueshëm për publikun.

Janë të gjitha këto arsye, të cilat na bëjnë t'i mbetemi strikt respektimit të parimit të integritetit, etikës profesionale dhe ligjshmërisë, për të mosdakordësuar me çfarë synon të përmbushë ky akt, në nivel parimor, përmbajtësor e sasior.

Sipas anëtarit të Komisionit Rregullator z. Muharrem Çakaj, renditen edhe këto argumente:

Theksoj se, një nga aktet më të rëndësishme që ky komision ka miratuar është akti mbi veprimtaritë e ndaluara.

(Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve").

Ishte pikërisht kjo garancia që u fut në Kodin Zgjedhor, pikërisht neni 91, mbi veprimtaritë e ndaluara, duke pasur parasysh se të gjitha palët do të garojnë në kushte të barabarta. Pra, do të ketë standarde dhe kushte të barabarta. Ajo u materializua në vendimin nr. 9, të Komisionit Rregullator, dhe prezumoi që të zbatohej së pari nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mënyrën se si ishte konceptuar. Pra, u hartua nga ky komision dhe do të duhej të zbatohej si nga Komisioneri, si nga organi tjetër, KAS, por nga të gjithë organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor.

Pra, në parim, për miratimin e këtij akti do të duhet të ishim në kushte të thjeshta. Thjesht do të duhet të miratonim në mënyrë formale rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Lind pyetja: A është ky rezultati përfundimtar i zgjedhjeve?! Pasqyra reale e votave, pasqyra reale e vullnetit të zgjedhësve shqiptarë?!

Janë katër arsye thelbësore, të cilat kanë ndikuar dhe kanë prodhuar këtë rezultat jo të drejtë në këto zgjedhje:

së pari, është mohimi i të drejtës kushtetuese të votimit të emigrantëve që duhet të vinin, siç kanë ardhur çdo palë zgjedhje, nga Greqia apo Maqedonia;

së dyti, është shpërndarja e parave të rindërtimit, vetëm një javë para zgjedhjeve, që ka ndikuar në gjykimin tim në mënyrë të drejtpërdrejtë në prodhimin e këtij rezultati;

së treti, është përdorimi i të dhënave personale, të të gjithë zgjedhësve shqiptarë, në kundërshtim të plotë me të gjithë legjislacionin në fuqi;

së katërti, propaganda e Kryeministrit me vaksinën ndaj COVID-19.

Por, jo vetëm kaq, është dhe shantazhimi me shprehjen e Kryeministrit se: *"Mos harroni se patronazhistët ju njohin mirë kush jeni"*.

Pikërisht, për gjithë sa më sipër renditur, shpreh mosdakordësinë dhe votën kundra aktit "Për miratimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021".

ANËTAR I KOMISIONIT RREGULLATOR
Helga Vukaj

ANËTAR I KOMISIONIT RREGULLATOR
Muharrem Çakaj

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 171
Datë: 2021/11/03 14:49:44
88714bd8-53de-40cf-883e-554add8e4173

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë